



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 20/1 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 25/ 05 / 2023

VENDIM

Nr. 15, date 25 /05/2023

PËR

HARTIMIN E PROJEKT- ZBATIMIT PER REHABILITIMIN E DIGES SE MANSKURISE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 25.05.2023 mori në shqyrtim kërkesën e Ndërmarrjes së Ujesjelles -Kanalizimeve Durrës sh.a (UKD) në lidhje me masat që duhet të merren për rehabilitimin e digës së Manskurisë që shfrytëzohet nga UKD.

Bazuar në kërkesën e paraqitur nga UKD si dhe nga inspektimet në terren të situatës, rezulton se gjendja e digës së Manskurisë është mjaft problematike dhe kërkon marrjen e masave urgjente përkatëse për rehabilitimin e digës dhe vënien në punë të Impiantit të trajtimit të ujit që furnizohet nga rezervuari i krijuar nga kjo digë si dhe për marrjen e masave në lidhje me sigurinë e digës dhe zonës së banuar poshtë saj. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm. KKDM

VENDOSI:

- Të miratoj kërkesën e UKD për hartimin e projektit të zbatimit për rehabilitimin e digës së Manskurisë. Projekti i zbatimit duhet të plotësojë kërkesat e nenit 5, pika B të ligjit Nr.8681 të mesipër si dhe kërkesat e nenit 9 të VKM nr. 147 në lidhje me përmbajtjen e projektit të zbatimit për miratim teknik në KKDM. Në mënyrë të veçantë, projekti i zbatimit duhet të përmbajë analizën e gjendjes ekzistuese të digës, llogaritjet dhe verifikimin e qendrueshmerisë së digës në kushtet aktuale dhe pas rehabilitimit të parashikuar. Raportin teknik për sistemet e monitorimit që duhet të instalohen në dige sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, kurben e vëllimeve aktuale të ujit për rezervuarin e Manskurisë bazuar në matje faktike batimetrike, raporte teknike për gjeologjinë, sizmikën hidrologjine dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm dhe të kërkuar në VKM e mesipërme. Projekti duhet të jetë i shoqëruar edhe me planin e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile si dhe me hartën e përmbajtjeve në zonën poshtë digës për rastet e prurjeve maksimale apo ndonjë shkatërrimi të mundshëm të digës.
- Projekti i zbatimit për rehabilitimin e digës së Manskurisë duhet të paraqitet për miratim në KKDM
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) si dhe Agjencia Kombëtare e Ujesjelles Kanalizimeve dhe Mbetjeve të ngurta (AKUM) të mbështesë UKD për marrjen e masave të kërkuara në lidhje me hartimin e projektit të zbatimit për Rehabilitimin e digës së Manskurisë si dhe Impiantit të Trajtimit të ujit me synim vënien në punë të këtij kompleksi dhe furnizimin me ujë të zonës përkatëse.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislativës në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

